




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008, neneve 13 dhe 14 të Rregullores për ndarjen e subvencioneve nga buxheti i Komunës Nr.15-011-23133 e datës 06.05.2015 si dhe Vendimit të Kuvendit të Komunës për dhënien e pëlqimit për ndarjen e mjeteve financiare 15Nr.400-11854 të datës 04.03.2016, Kryetari i Komunes duke vendosur sipas kërkesës së KV "Ulpiana" (femrat) në Lipjan, nxjerr

VENDIM PËR MBËSHTETJE FINANCIARE

Neni 1

I ndahet shuma e mjeteve në vlerë prej 5'000 € (pesëmijë mijë euro), Klubit të Volejbollit "Ulpiana" (femrat) në Lipjan, sipas kërkesës së tyre të datës 01.02.2016 në pajtim me Vendimin e Kuvendit të Komunës për dhënien e pëlqimit për ndarjen e mjeteve financiare 15Nr.400-11854 të datës 04.03.2016 për ta mbështetur financiarisht për mbulimin e shpenzimeve të domosdoshme të Klubit për përfundimin e sezonit për vitin 2016 dhe mbarëvajtjen e garave sportive.

Shuma e cekur financiare në paragrafin 1 të këtij neni do të paguhet brenda vitit 2016 në dy kiste të barabarta si vijon:

Kisti i parë në shumë prej 2'500 € (dymijë e pesëqind euro) dhe
Kisti i dytë në shumë prej 2'500 € (dymijë e pesëqind euro).

Neni 2

Shuma e cekur në nenin 1 të këtij Vendimi do të paguhet nga mjetet e buxhetit të Komunës së Lipjanit për vitin 2016, pozicioni buxhetor- subvencionet e planifikuara për Drejtoratin për Kulturë, Rini dhe Sport në xhirollogarinë bankare të Klubit nr. 1300271200145524 BPB - Banka për Biznes.

Neni 3

Lidhur me mjetet e shpenzuara Klubi duhet të sjellë raport financiar për shpenzimin e mjeteve, deri në shumën e lejuar . Pas shpenzimit të mjeteve të kistit të parë duhet të sillet raport financiar mbi shpenzimet duke i bashkëngjitur faturat të cilat duhet të jenë në përputhje me nevojat e parqitura në kërkesë. Kisti i dytë do të paguhet pas dërgimit të raporteve të cekura mbi shpenzimet nga kisti i parë dhe në fund të vitit do të sillet raporti

mbi shpenzimet e kistit të dytë dhe të dy raportet dhe faturat e bashkëngjitura do të dorëzohen në Drejtoratin për Kulturë, Rini dhe Sport.

Neni 4

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet të Klubi i Volejbollit "Ulpiana" (femrat) në Lipjan.

1Nr.400-4748

Lipjan, më 29.03.2016

KRYETARI I KOMUNES
Imri Ahmeti

